

# STATUTI

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“RIAL TRAVEL” Sh.p.k

### HYRJE

#### NENI 1

Shoqëria me përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar “RIAL TRAVEL”, sh.p.k krijohet në bazë të inisiativës dhe kapitalit themeltar të aksionerëve themelues, në bazë të Aktit të Themelimit, Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe Ligjin Nr.9723, date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” (i ndryshuar), për të ushtruar aktivitetin e saj si person juridik i pavarur nga ortakët themelues të shoqërisë respektivisht :

- Albert Çela, i biri i Aliut dhe i Sajdes, lindur në Fier i Ri Krutje, me 13.09.1964, banues ne Lushnje, ne adresen: Rruga “Dora Distria”, Lagja “KONGRESI”, Lushnje, me Nr.Personal G40913050W.

#### NENI 2

Shoqëria krijohet dhe ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi ligjin nr.9901, date 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Ligjin Nr.9723, date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar), si dhe me dispozitat e këtij Statuti.

### KREU I

#### EMERTIMI I SHOQERISE, , SELIA, OBJEKTI dhe KOHEZGJATJA

#### EMËRTIMI

##### NENI 3

Emri i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar është “RIAL TRAVEL” Sh.p.k

#### SELIA

##### NENI 4

Selia e Shoqërisë ndodhet ne LUSHNJE ne Adresen: Krutje, Lagja Pushimi Shoferit, banese private Nr 12, Lushnje.

Aktiviteti i saj do të zhvillohet në Lushnje dhe do të shtrihet në të gjithë territorin shtetëror të Republikës së Shqipërisë.

#### OBJEKTI

##### NENI 5

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë si më poshtë vijon :

**Agjensi komisionere. Veprimtari e agjentit për transferte parash në emer**

**dhe për llogari të një subjekti financiar jo banke. Veprimtari e agjentit për shërbimin e pagesave për të tretet në emer dhe për llogari të një subjekti financiar jo banke. Shërbimet Unionet-Westen Union.**

**Kembim valutash. Pagesa Faturash Oshee, Uje , lute kredit,Mogo,Biletari,Siguracione. Rimbushje elektronike (Dixhitalb,vodafon,telekom,eagle,abcom), dhe çdo lloj veprimtarie tjetër e lejuar nga legjislacioni shqiptar.**



**KOHËZGJATJA**  
**NENI 6**

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj per nje afat te pacaktuar, duke filluar nga koha e rregjistrimit në Qendën Kombëtare të Biznesit.

Për shkaqe dhe arsye të ndryshme, ajo mund të mbarojë aktivitetin e saj dhe para këtij afati.

Kjo do të bëhet në përputhje me dokumentet ligjore të themelimit të shoqërisë Akt Themelimi dhe Legjislacionin në fuqi.

**KREU II**  
**KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT**  
**THEMELTAR**

**NENI 7**

**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 (njqind) leke.

Shoqeria mund te zmadhoje ose zvogeloje kapitalin e saj.

Zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit vendoset nga Asambleja e Ortakut .

**NENI 8**

Kapitali themeltar perbehet nga kontributet e meposhtme:

1. Albert Çela kontribon ne shumen 100 (njqind) leke.

**NENI 9**

Ne baze te kontributeve te siperpermendura:

Te gjitha pjeset qe perbejne kapitalin themeltar jane nenshkruar dhe shlyer plotesisht nga ortaku i vetem.

**NENI 10**

**Lenia dhe trasferimi i pjeseve te kapitalit**

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve dhe ne rruge trashegimie.

Pjeset e kapitalit themeltar mund tu trasferohen te treteve vetem me miratimin e ortakut.

**NENI 11**

Shoqeria mund të ketë edhe kontribute në para dhe në natyrë.

Këtu përfshihen të gjitha sendet e paluajtshme në shërbim të shoqërisë, si dhe ato të luajtshme, të cilat kalojnë në pronësi të shoqërisë.

**NENI 12**



## FONDET E SHOQËRISË

Shoqëria përcakton fondet:

- Fondi Themeltar (qarkullues)
- Fondi rezervë.
- Fonde të tjera që mund të jenë të nevojshme gjatë veprimtarisë së saj madhësia e secilit fond, përcaktohet mbi bazën e vendimit të Asamblesë së Ortakëve, I cili merr vendim gjithashtu edhe për qëllimin e përdorimit të tij.

### DREJTIMI ADMINISTRATIV NENI 13

Shoqëria ka si organe drejtuese të saj:

- Asambleja e ortakëve themelues të Shoqërisë.
- Administratori.

Administratori i vetem i kesaj Shoqërie, me një afat prej 5 (pesë) vjetësh, do të jetë Devis CELA, e bija i Albertit dhe i Zyrakos lindur në Lushnje, me 09.12.1989, banues ne Lushnje, ne adresen: Rruga "Dora Distria", Lagja "KONGRESI", Lushnje, me Nr.Personal I91208083M.

### NENI 14

Ortakët themelues të shoqërisë "RIAL TRAVEL" sh.p.k, për administrimin e saj ose të aktiviteteve të vecanta kanë të drejtë të emërojnë një ose disa persona të tjerë administratorë të shoqërisë. Kompetencat e administratorëve përcaktohen në aktin e emërimit të tyre, të lëshuar nga Asambleja e ortakëve themelues të shoqërisë.

### NENI 15

Shoqëria nuk merr përsipër veprime që mund të kryejnë administratorë të tjerë të mundshëm në marrëdhënie me persona të tretë që i tejkalojnë kompetencat e tyre të përcaktuar në aktin e emërimit.

### NENI 16

Administratori për të shqyrtuar bilancin vjetor, të ardhurat e qarkulluara dhe mënyrën e mbajtjes së rregjistrave të veprimeve kontabël, emëron një ose disa ekspertë kontabël.


Emërimi i ekspertëve kontabël është i detyrueshëm për rastet e parashikuar me ligj.

### KOMPETENCAT E AKSIONERËVE

### NENI 17

Përsa kohë që shoqëria do të jetë me shumë ortakë, kompetencat e tij do të jenë:

- Vendosin për ndryshimet në Statutin e Shoqërisë dhe miratojnë rregulloret për sektorët e veçantë të saj.
- Emërojnë dhe shkarkojnë administratorët dhe përcaktojnë kompetencat e tyre me aktin e emërimit.



- Shqyrtojnë dhe vendosin për bilancin vjetor, kuotat e fondeve të ndryshme dhe fitimit të realizuar.

## KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

### NENI 18

Administratori ka këto detyra dhe kompetenca:

- Të punojë të organizojë e të drejtojë në mënyrë efikase që të sigurojë sukses në veprimtarinë ekonomike – financiare të shoqërisë..
- Të zbatojë vendimet e marra nga ortakët dhe urdhërat e tyre të dhëna brenda kompetencave të përcaktuara në statut dhe legjislacioni në fuqi..
- Të paraqesë rregullisht para ortakëve: raportin e administrimit, inventarët e pasurisë, bilancin vjetor të llogarive, por jo më vonë se 4 muaj nga mbyllja e vitit financiar paraardhës.
- Përcakton dhe realizon cmimet e punimeve të kryera dhe të shitjes së artikujve për treg, si dhe cdo lloj shitblerje tjetër.
- Vendos për pagat e personelit dhe specialistëve.
- Ndjek problemet e shoqërisë në marrëdhëniet me organet e ndryshme shtetërore dhe me personat e tjerë fizikë dhe juridikë.

## KREU IV

### VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE

#### NENI 19

##### Viti financiar, llogarite vjetore

Cdo vit financiar fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor.

Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta të hartuara nga Administratori dhe eventualisht, nga eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga Asambleja, me vendim të ortakeve që zoterojnë mbi 1/2 e pjeseve të kapitalit themeltar.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore behen brenda nje afati prej 3 muajsh nga dita e mbylljes se vitit financiar.

#### NENI 20

##### Dividentet

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, Asambleja e ortakeve përcakton pjesën që u takon ortakeve në formën e dividenteve mbi fitimin. Fitimi, që do të ndahet ndërmjet ortakeve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar, përbehet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lena menjëherë për fondin rezerve të domosdoshëm (5 % e fitimit të cdo viti, deri sa ky fond të arrijë vlerën 1/10 e kapitalit themeltar) dhe nga ana tjetër i janë zbritur ose i janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

## KREU V

### PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

#### NENI 21



Shoqeria nuk prishet kur njeri prej ortakëve falimenton, behet i paafte ose vdes.

#### **NENI 22**

Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi Asambleja emerone nje likujdues, i cili i paraqet asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetin te Shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

#### **NENI 23**

Te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se Shoqerise ose gjate periudhes se likujdimit, lidhur me interpretimin e ketij Statuti apo te akteve te tjera te Shoqerise, ose mosmarreshjet qe mund te lindin gjate ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise do te zgjidhen me mirekuptim. Ne rast se ky nuk arrihet, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete gjykata e rrethit Tirane.

**Dt 17/06/2020**

**ORTAKU THEMELUES**

**ALBERT ALI ÇELA**

